

VENDIM
Nr. 13, datë 18.1.2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 122, DATË 5.3.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA E MADHE E
TIRANËS (KOMUNA E PARISIT–RRUGA E KAVAJËS)’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 122, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqet “tokë”, me vlerë 464 014 103.6 (katërqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e katërmëdhjetë mijë e njëqind e tre pikë gjashtë) lekë, “objekte”, me vlerë 552 299 823 (pesëqind e pesëdhjetë e dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekë, “kultura bujqësore”, me vlerë 1 561 500 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë, dhe “truall”, me vlerë 737 208 (shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetë) lekë”.

“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për “tokë”, “objekte”, “truall” dhe “kultura bujqësore” është 1 018 612 634.6 (një miliard e tetëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër pikë gjashtë) lekë.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6.1, me këtë përmbajtje:

“6.1 Vlera shtesë e shpronësimit, prej 1 063 927 (një milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e njëzet e shtatë) lekësh, përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

II. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

IV. Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 122 datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet edhe tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

V. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në 122, DATË 5.3.2014, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘UNAZA E MADHE E TIRANËS (KOMUNA E PARISIT-RRUGA E KAVAJËS)’, TË NDRYSHUAR”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Numri ipasurisë	Sip. totale m ²	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			TOKE ARË			Ndërtesë soc., ek.		Vlera totale (lek)	SHËNIME	ADRESA
								Sipërfaqja	Çmimi	Vlera								
								e shpronësuar (m ²)	(lek/m ²)	lekë	Sipërfaqe e shpronësuar	Çmimi (lek/m ²)	Vlera lek	Sipërfaqe e shpronësuar	Vlera sipas preventivit			
1	SEID	OSMAN	MERSINI	3292	112/55	250	TRUALL	6	3,413	20,478				16	326,719	347,197	Kufizohen veprimet mbi pasurinë në bazë të SHK ZQRPP nr. 6287/3, datë 26.10.2006, deri në një urdhër të dytë. Urdhri nr. 1914, datë 26.9.2011.	Tiranë
2	ADELINA	ISA	BANA	3292	100/40	210	TRUALL	210	3,413	716,730						716,730	Konfirmuar nga ASHK-ja Tiranë	Tiranë
	AVDULLA	DURO	BANA															
	TOTALI									737,208					326,719	1,063,927		